



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 7358 / Prot.  
1

Datë 4 / 11 / 2022

UDHËZIM

Nr. 30, Datë 4 / 11 / 2022

PËR

**PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE AFATEVE TË APLIKIMIT, SI DHE TË  
PROCEDURAVE TË PËRCAKTIMIT TË MASËS DHE MËNYRËS SË FINANCIMIT  
TË STUDENTËVE TË SHKËLQYER DHE ATYRE QË NDJEKIN PROGRAME  
STUDIMI QË PËRBËJNË PRIORITET KOMBËTAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të pikës 6 të vendimit nr. 386 datë 1.6.2022, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, Ministri i Arsimit dhe Sportit,

UDHËZOJ:

1. Studentët shtetas shqiptarë, që regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2022-2023, e në vijim, të cilët plotësojnë njërin nga kriteret e parashikuara në shkronjat (a) (b) dhe (c), të pikës 2, të vendimit nr. 386, datë 01.06.2022 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë”, aplikojnë për mbështetje financiare pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), brenda muajit janar të vitit akademik, në të cilin pranohen në institucionet publike të arsimit të lartë.
2. Studentët kanë mundësinë e aplikimit për përfitimin e mbështetjes financiare, nëse plotësojnë njërin nga tre kriteret si më poshtë:

- a) Studenti ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00 dhe në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore është vlerësuar me jo më pak se nota e përshkallëzuar 9.5 deri në 10.00;
  - b) Studenti është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare të arsimit parauniversitar, me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, pavarësisht notës mesatare, kur pranohet në programe studimi, që lidhen me lëndën/t/disiplinën ku ka fituar çmimin;
  - c) Studenti ka zgjedhur të ndjekë një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar dhe që ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare, jo më pak se 8.5, përfshirë notën e përshkallëzuar të provimeve kombëtare të detyruara të maturës shtetërore.
3. Studentët aplikojnë duke depozituar dokumentet provuese, origjinal ose kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:
    - kërkesën për aplikim;
    - dokument identifikimi (fotokopje);
    - diploma dhe certifikata e maturës shtetërore;
    - vërtetim nga institucioni publik i arsimit të lartë, që aplikanti është pranuar në një program studimi;
    - certifikatën e fitimit të olimpiadës, sipas kërkesave të shkronjës “c”, të pikës 2, të vendimit nr. 386 datë 1.06.2022 të Këshillit të Ministrave.
  4. Pas përfundimit të afatit të aplikimeve, AKFAL bën verifikimin e informacionit të paraqitur në aplikimin e çdo studenti. Për këtë qëllim merret informacion zyrtar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, për të verifikuar përmbushjen e kriterëve.
  5. Pas marrjes së konfirmimeve përkatëse, AKFAL harton listën përfundimtare me të gjithë studentët përfitues, të cilët plotësojnë kriteret për të përfituar mbështetje financiare dhe ia përcjell ministrisë përgjegjëse për arsimin. Bazuar në këtë listë, ministria përgjegjëse për arsimin akordon fondin për çdo institucion publik të arsimit të lartë.
  6. Brenda 10 ditëve nga miratimi i listës përfundimtare, sipas pikës së mësipërme, studentët përfitues dhe institucionet publike të arsimit të lartë, ku ata janë regjistruar, njoftohen për të lidhur marrëveshjen trepalëshe mes përfituesit të financimit ose përfaqësuesit ligjor të tij, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe institucionit publik të arsimit të lartë.
  7. Një kopje zyrtare e marrëveshjes së nënshkruar, jo më vonë se dy ditë nga data e nënshkrimit, i përcillet çdo institucioni publik të arsimit të lartë, ku është regjistruar student i përfitues i fondit të mbështetjes financiare.

8. Pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, çdo muaj, institucioni publik i arsimit të lartë duhet të kryejë pagesën në llogarinë bankare të përfituesit, e cila është përcaktuar në marrëveshjen e nënshkruar. Masa e financimit nuk mund të tejkalojë nivelin e pagës minimale në shkallë vendi.
9. Për studentët, të cilët mund të kenë kryer pagesën e tarifës së shkollimit, institucioni publik i arsimit të lartë, menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, duhet të bëjë rimbursimin e tarifës së paguar.
10. Për studentët përfitues, për vitet ne vijim pas vitit akademik 2022-2023, AKFAL do të bëjë verifikimin e plotësimit të kërkesave të pikës 4 të vendimit nr. 386 datë 01.06.2022 të Këshillit të Ministrave. Për këtë qëllim, studentët përfitues duhet të depozitojnë, brenda muajit tetor, listën e notave dhe vërtetimin për shlyerjen e të gjithë detyrimeve të vitit paraardhës, sipas përcaktimeve të pikës 4 të vendimit nr. 386 datë 1.06.2022 të Këshillit të Ministrave. AKFAL do të marrë konfirmim nga institucionet publike të arsimit të lartë, për notën mesatare të studentëve përfitues, brenda muajit nëntor. Në rast të mosplotësimit të kriterëve të notës mesatare, studenti e humb të drejtën e përfitimit të mbështetjes financiare për vitin akademik pasardhës. Në këtë rast, AKFAL njofton studentin, institucionin publik të arsimit të lartë dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin.
11. Për vitet akademike pasardhëse, pas vitit akademik të nënshkrimit të marrëveshjes tre palëshe, lista me të gjithë përfituesit e çdo viti akademik do të miratohet brenda muajit dhjetor, duke njoftuar studentët përfitues dhe institucionet publike të arsimit të lartë.
12. Pas nënshkrimit të marrëveshjes tre palëshe, konfirmimi i frekuentimit të programit përkatës të studimit nga studentët përfitues, për çdo muaj të pjesës së mbetur të vitit akademik kur është nënshkruar marrëveshja, si dhe për çdo muaj të viteve akademike në vijim, do të bëhet nga institucioni publik përkatës i arsimit të lartë.
13. Fondet për mbështetjen financiare të studentëve sipas këtij udhëzimi, përballohen nga buxheti i ministrisë së arsimit dhe sportit, që i akordohet institucioneve publike të arsimit të lartë, në programin 09450, në formë grandë.
14. Për vitin 2022, për ato institucione publike të arsimit të lartë, të cilat do të kenë nevojë për fonde shtesë për përballimin e efekteve financiare që burojnë nga zbatimi i këtij udhëzimi, këto fonde shtesë do të kompensohen nga ministria përgjegjëse për arsimin.
15. Udhëzimi nr. 27, datë 02.08.2022 i Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për përcaktimin e rregullave, afateve të aplikimit, shqyrtimit dhe procedurat e masës dhe mënyrës së

financimit të studentëve të shkëlqyer dhe atyre që ndjekin programe që përbëjnë prioritet kombëtar” shfuqizohet.

16. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe institucionet publike të arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

Evis KUSHI

MINISTËR

